



Bazuar në nenin 17 pika b) dhe j) e Statutit të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.Prishtinë, neni 8 i Ligjit 03/L-212 i Punës, Rregullores nr.02/308 dt.04.03.2025 për Themelimin e marrëdhënies së punës në Ndërmarrjen Publike "Stacioni i Autobusëve" sh. A prishtinë Rregullores nr.02/147 datë 31.01.2025 për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës, Rregulloren nr.02/527 dt.25.06.2018 për përcaktimin e pagës dhe çështjeve tjera të suksesit të punës së punëtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.Prishtinë me të gjitha plotesim/ndryshimet, Vendimin nr.02/1057 datë:19.06.2025, UD Kryeshefi Ekzekutiv SHPALL:

## KONKURS I JASHTËM

**Pozita e Punës:** Punëtorë i sigurimit – 1 Pozitë pune.

**Kohëzgjatja e Kontratës së punës:** Me Kohë të Pacaktuar, ndërsa puna provuese 3 deri në 6 muaj;

**Paga Mujore:** 561.2 €.

**Përshkrimi gjeneral:** Bën ruajtjen e pasurisë, ndërtesës dhe mjeteve themelore

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Bën ruajtjen e pasurisë, ndërtesës dhe mjeteve themelore;
- Siguron objektet dhe pasurisë në përgjithësi në aspektin e sigurisë fizike
- Është përgjegjës për çdo humbje në kompani gjatë ndërrimit të tij
- Pas përfundimit të orarit, bën inspektim për të verifikuar se a është gjithçka në rregull
- Pas çdo ndërrimi të raportojë të Zyrtares përgjegjëse të sigurimit për ato që ndodhin gjatë ndërrimit
- Nuk lejon hyrjen dhe prezencën e paleve të pautorizuara gjatë ditës dhe natës në objektin e ndërmarrjes
- Kujdeset që të mos ketë rrezik të shkakut të ndonjë zjarri në ndërtesën e Stacionit të Autobusëve, dhe nëse shkaktohet ndonjë gjë e tillë, është i obliguar që me kohë të lajmëroj organet kompetente dhe udhëheqësin e tij për evitimin e zjarrit;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha veprimtaria e vet dhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit.
- 

**Kualifikimet dhe Aftësitë:**

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Përvojë pune 1 (një) vjeçare;
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi (komunikimi verbal, dhe në të shkruar);
- Njohja e gjuhëve zyrtare;
- Preferohet njohja e gjuhëve të huaja.

### **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

1. Aplikacioni i Punësimit të plotësuar;
2. CV e aplikantit.
3. Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimin te kopjuar.
4. Dëshmia e kualifikimit shkollor;
5. Kopjet e certifikatave, referencave tjera profesionale që ndërlidhen me pozitën që aplikoni.
6. Dëshmit mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust.
7. Dëshminë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedure penale ndaj tij/saj, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

### **Mënyra e aplikimit:**

- Aplikimi për konkursin e shpallur duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike, aplikacioni merret ne faqen zyrtare të ndërmarrjes [www.sap-rks.com](http://www.sap-rks.com) – vegza “Konkurse” dhe dorëzohet në adresën elektronike: [konkurse@sap-rks.com](mailto:konkurse@sap-rks.com);
- Dokumentet duhet të bashkangjiten sipas kërkesave të konkursit në versionin PDF.
- Pas aplikimit të suksesëshëm do të pranoni një email konfirmues.
- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim;
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve te rinj;

### **Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:**

- Mënyra e vlerësimit do të bëhet në bazë të Rregullores nr.02/308 dt.04.03.2025 për themelimin e marrëdhënies së punës në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë, neni 19 .
- Vlersimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit.
- Për pozitën të cilat kërkohet testimi me shkrim, jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë dhe intervistimi deri në njëzetë (20) pikë

### **Kalendari i përafërt i përfundimit i procedurës së rekrutimit:**

- Bazuar në diapozitat e Rregullores nr.02/308 dt.04.03.2025 për themelimin e marrëdhënies së punës në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë, neni 10 pika 10.5 afati për marrjen e vendimit për përzgjedhjen të kandidatit të përshtatshëm është 30 ditë që nga dita mbyllja së konkursit për pozitën e punës “Punëtor i sigurimit” .

### **Mënyra e njoftimit për rezultatet e konkursit:**

- Kandidatët për rezultatet e fazave të procedurës së rekrutimit do njoftohen në mënyrë individuale dhe ne formën elektronike.

**Konkursi është i hapur 15 ditë duke përfshirë ditën e publikimit nga dt: 20.06.2025 deri më datë:04.07.2025 në ora: 16:00h.**

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.